



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK NË ZBATIM TË LIGJIT NR.138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 14.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumemërore për këshillat bashkiak, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



**Nr . 309 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumemërore për Këshillat Bashkiak ,në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

## VËREN

Partia e Gjelbër, pjesëtare e Koalicionit Aleanca për Shqipërisë Europiane, në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillin e bashkisë Mat, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiak, rezulton asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa c, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për të kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, sipas së cilës rezultojnë të padënuar nga gjykatat shqiptare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr.2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e listës shumemërore për këshillin e Bashkisë Mat, Qarku Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, germa "f", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



### **Nr . 309 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumemërore për Këshillat Bashkiak ,në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

## **VENDOSI:**

1. Njoftimin e KZAZ-së nr. 16 për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Mat, Partia e Gjellbër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



### **Nr . 309 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak ,në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".